



Pranimar / Doretuar Pamirimi/Prodato Received/Delivery	30-01-3	viti god year
Organ /Njësia Organ /Jednica Org /Unit	Nr Prot Br Prot Prot No	Shtojca Prilog Appendix
SKIMSHUK	1102/2023	Sasia Kolicina Quantity 1/5



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBE KOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.1205/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave i përbërë nga: Eshref Shabani-kryetar, Malsore Gashi-Bajraktari dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën me numër A.nr.1205/2022 të datës 16.12.2022 të parashtruar nga ankuesja

kundër Vendimit me numër KD.Nr.8/22 të Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë i datës 24.11.2022, në çështjen juridike “Masë disiplinore”, duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr. 02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim me datë 29.01.2023, mori këtë:

V E N D I M

I. Refuzohet si e pabazuar ankesa me numër A.nr.1205/2022 e datës 16.12.2022 e parashtruar nga ankuesja

II. Mbetë në fuqi Vendimit me numër KD.Nr.8/22 i Komisionit Disiplinor të Ministrisë së Drejtësisë i datës 24.11.2022.

A r s y e t i m

Ankuesja e cila sipas shkrësive të lëndës është e punësuar në Avokaturën Shtetërore pranë Ministrisë së Drejtësisë, me datë 16.12.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimet Civil e cila është regjistruar me shenjën A.nr.1205/2022 dhe numër protokoli:8156/2022, kundër Vendimit me numër KD.Nr.8/22 të Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë i datës 24.11.2022.

Ankuesja në ankesën e parashtruar në Këshill pretendon se Komisionin Disiplinor me rastin e shqiptimi të masës disiplinore, ka bërë konstatim të gabuar të gjendjes faktike, ka shkelur dispozitat e Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik si dhe dispozitat e Ligjit për Procedurën e Përgjithshme

Administrative, me kërkesën që Këshilli të aprovojë ankesën e ankueses si të bazuar , ndërsa të anulojë Vendimin e Komisionit Disiplinor të datës 24.11.2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbim Civil të Kosovës me datën 27.12.2022 ka dërguar kërkesën për përgjigje në ankesë të ankuesit tek Ministria e Drejtësisë. Ndërsa me datën 13.01.2023 Këshilli ka pranuar përgjigjen në ankesë me shkresat e bashkangjitura.

Kolegji për shqyrtimin dhe vendosjen e ankesave për marrjen e vendimit merit administrator këto prova: Ankesën me numër të protokollit 8156/2022 të datës 16.10.2022 të parashtruar nga ankuesi në Këshill; E-mailin i dërguar nga I.A drejtuar F.G e datës 23.09.2022; E-mailin i dërguar nga F.G drejtuar I.A e datës 16.09.2022; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.1748/16 i datës 15.08.2022; E-mailin i dërguar nga I.A drejtuar I.T i datës 23.09.2022; Ftesë gjyqësore për seancën e datës 27.06.2022; Raporti për seanca prej datës 11.07.2022 deri 15.07.2022; Email i dërguar nga N.B drejtuar A.S e datës 26.11.2019; E-mailin i dërguar nga K.SH drejtuar I.Z e datës 30.11.2021; E-mailin i dërguar nga A.S drejtuar K.SH e datës 16.01.2020; Procesverbal mbi shqyrtimin kryesor për A.nr.1748/2016 e datës 15.01.2020; Ftesë për seancën e datës 01.10.2021; E-mailin i dërguar nga K.SH drejtuar N.B e datës 06.09.2021; E-mailin i dërguar nga N.B drejtuar B.M e datës 10.11.2021; Procesverbal mbi shqyrtimin kryesor për A.nr.1748/2016 e datës 10.11.2021; Autorizim me nr.prot.05-6956 i datës 27.10.2021; E-mailin i dërguar nga N.B drejtuar B.M i datës 10.11.2021; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.2883/2018 i datës 05.07.2022; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.2924/2019 i datës 22.08.2022; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.522/2021 i datës 29.10.2022; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.2595/2018 i datës 29.09.2022; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.744/2021 i datës 04.08.2022; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.852/2021 i datës 13.09.2022; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr. 1674/2020 i datës 07.09.2022; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr. 2742/2021 i datës 23.11.2022; Kërkesa për përgjigje në ankesë e datës 27.12.2022; Përgjigja në ankesë e datës 13.01.2023; Akt emërimi i ankueses i datës 03.11.2016; Konkurs me numër të referencës RPC0002852 i datës 06.06.2022; Lista e distribuimit me numër 02-923 e datës 26.09.2022; E-mailin i dërguar nga F.G drejtuar A.N i datës 23.09.2022; E-mailin i dërguar nga F.G drejtuar I.A e datës 08.09.2022; E-mailin i dërguar nga Zyra për komunikim me publikun-MD drejtuar F.G e datës 23.09.2022; E-mailin i dërguar nga A.N drejtuar I.A e datës 03.10.2022; E-mailin i dërguar nga A.N drejtuar I.A e datës 26.09.2022; E-mailin i dërguar nga A.N drejtuar F.G e datës 03.10.2022; Vendim i Ministrisë së Drejtësisë me numër 02-923/2 e datës 25.10.2022; Procesverbal për lëndën 02-923 i mbajtur me datë 05.10.2022 ora 11:00; Procesverbal për lëndën 02-923 i mbajtur me datë 05.10.2022 ora 09:30; Vendim i Komisionit Disiplinor me KD.nr.8/2022 i datës 24.11.2022; Plotësim i ankesës për lëndën A.nr.1748/2016 i datës 03.10.2022; Procesverbal mbi shqyrtimin kryesor për A.nr.1748/2016 i datës 21.12.2021; Procesverbal mbi shqyrtimin kryesor për A.nr.1748/2016 i datës 10.11.2021; Ftesë për seancë gjyqësore për datën 08.09.2021; Ftesë për seancën e datës 15.01.2020; Procesverbal mbi shqyrtimin kryesor A.nr.1748/2016 i datës 23.10.2019; Kërkesë për përfaqësim me nr.prot.05-7649 i datës 02.12.2021; Kopje e librit të regjistrimit të lëndëve; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.2147/14 i datës 10.01.2017; Aktgjykim i Gjykatës së Apelit në Prishtinë AAnr.231/2018 i datës 20.09.2019; Aktgjykim i Gjykatës së Apelit në Prishtinë AAnr.1115/2021 i datës 15.09.2022; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.1095/2017 i datës 06.10.2020; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.455/2011 i datës 03.02.2015; Aktgjykim i Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr.154/2015 i datës 04.11.2015; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.13/17 i datës 07.05.2019; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.2110/2014 i datës

19.01.2017; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.2108/2014 i datës 11.01.2017; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.1015/2018 i datës 13.07.2022; Aktgjykim i Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr.206/2022 i datës 25.08.2022; Aktgjykim i Gjykatës Supreme të Kosovës ARJ-UZVP.NR.33/2021 i datës 29.06.2022; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.1589/2020 i datës 15.09.2022; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.417/15 i datës 22.12.2016; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.1841/2014 i datës 11.01.2017; Aktgjykim i Gjykatës së Apelit në Prishtinë AA.nr.851/2021 i datës 16.09.2022; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.2320/2014 i datës 15.02.2017; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.1663/2020 i datës 23.06.2022; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.141/2019 i datës 03.06.2022; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.433/2019 i datës 23.06.2022; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.311/2017 i datës 07.06.2022; Aktgjykim i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.2156/2019 i datës 10.06.2022; Parashtresë për Gjykatën Themelore në Prishtinë e datës 17.12.2021; Dëshmi e dorëzimit të provës në Gjykatën Themelore në Prishtinë me datën 17.12.2021 për lëndën A.nr.1748/2016; Aktvendim i Gjykatës Themelore në Prishtinë A.nr.1748/2016 e datës 21.01.2022.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, pasi ka shqyrtuar të gjitha shkresat e bashkangjitura të lëndës të dërguara nga palët në procedurë, ka konstatuar se ankesa e ankueses është e pa bazuar, sepse:

Kolegji i Këshillit nga administrimi i shkresave të lëndës ka konstatuar se ankuesja sipas Aktit të Emërimit të datës 01.11.2016 mban pozitën e punës "Avokat Shtetëror" në Avokaturën Shtetërore të Republikës së Kosovës në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë, ndërsa Komisioni Disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë përmes Vendimit me numër KD.Nr.8/22 të datës 24.11.2022, i ka shqiptuar masën disiplinore "Ndalim nga 20% të pagës periudhë deri në dy (2) muaj".

Po ashtu, Kolegji i Këshillit nga shkresat e lëndës ka gjetur se inicimin e procedurës disiplinore ndaj ankueses e ka bërë udhëheqësja e drejtpërdrejtë e ankueses, gjegjësisht Zëvendësuesja e Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror me arsyetimin se ankuesja ka kryer shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore të përcaktuara me ligjin material dhe ligjit për avokaturën shtetërore, ndërsa Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së Vendimit me numër KD.Nr.8/22 të datës 24.11.2022, i ka shqiptuar masën disiplinore "Ndalim nga 20% të pagës periudhë deri në dy (2) muaj", ngase të njëjtën e ka gjetur përgjegjëse për shkelje të rënda disiplinore të përcaktuara në nenin 46 paragrafi 3 në paragrafi 3.1 dhe 3.2 pasi që e njëjta ka qenë e ngarkuar më lëndën A.nr.1748/16 të datës 15.07.2022 e ka cila ka qenë në proces gjyqësor, ndërsa ankuesja ka qenë e ngarkuar me lëndën në fjalë pasi që Avokature Shtetërore ka qenë duke e përfaqësuar Ministrinë së Shëndetësisë si palë në procedurë, ndërsa ankuesja nuk i është përgjigjur ftesës së gjykatës për mbajtjen e seancës së shqyrtimit kryesor dhe se mungesën e saj nuk e ka arsyetuar.

Me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore, Kolegji i Këshillit ka analizuar përmbajtjen e Aktgjykimit A.nr.1748/16 të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative të datës 15.07.2022 përmes të cilit është vendosur që të aprovohet kërkesëpadia e paditësit "Jona Med" Sh.P.K, e ka anuluar vendimin e të paditurës Organi Shqyrtues i Prokurimit (OSHP), PSH.Nr.55/11; Nr.56/11 i datës 02.06.2016 si të kundërligjshëm, ndërsa e ka obliguar Ministrinë e Shëndetësisë si palë me interes juridik, duke e detyruar të njëjtën që t'ia paguajë shumën e përgjithshme prej katërqind e njëzetetremijë e katërdhjetë e pesë Euro pikë pesëdhjetë e shtatë centë (423,045.57 €) me kamatën ligjore prej 8% në vit, tutje në arsyetimin e këtij aktgjykimi gjykata ka konstatuar se në seancën e shqyrtimit kryesor, palët janë ftuar me rregull,

ndërsa për palën e paditur dhe palën e interesit nuk ka përfaqësuar askush duke mos e arsyetuar as mungesën në këtë seancë, ndërsa gjykata seancën e shqyrtimit kryesor e ka mbajtur në prani të palës paditëse konform nenit 41 të Ligjit Nr.03/L-202 për Konfliktet Administrative.

Ndërlidhur me mungesën e ankueses në seancën e shqyrtimit kryesor të lëndës pranë Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, e njëjta mungesën në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 15.07.2022 e arsyeton me faktin se Ministria e Shëndetësisë asnjëherë nuk ua kishte siguruar dosjen fizike të lëndës edhe pse ishte palë më interes në konfliktin administrativ, dhe se sipas ankueses pjesëmarrja në këtë seancë pa mbështetjen e provave nuk do të ndryshonte vendimmarrjen nga ana e gjykatës, ndërsa nga shkresat e lëndës gjegjësisht korrespondencën ndërmjet Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Shëndetësisë me zyrtarët e kësaj ministrie vërehet fakti se dosja e lëndës në fjalë mungon, ndërsa Avokatura Shtetërore kishte marr përgjegjësinë e përfaqësimit të kësaj lënde pas takimit të datës 31.11.2021 me përfaqësuesit e Ministrisë së Shëndetësisë, gjegjësisht sipas deklarimeve të Zëvendësuesja e Avokatit të Përgjithshëm Shtetëror, lënda është marr në përfaqësim nga datat 02.12.2021

Kolegji i Këshillit me qëllim të shqyrtimit të ligjshmërisë së pretendimeve ankimore ndërlidhur më masën e shqiptuar disiplinore, ka analizuar dispozitat ligjore të nenit 46 paragrafi 1 dhe 3 nën paragrafi 3.1 dhe 3.2 të Ligjit Nr.06/l-114 për Zyrtarët Publik që përcakton se: *"1. Shkelje disiplinore konsiderohen shkelje të detyrave të punës dhe detyrimeve ligjore, duke përfshirë mundësinë e shqiptimit të masave disiplinore; dhe 3. Shkelje të rënda konsiderohen: 3.1. Mos përmbushja e detyrave të punës; 3.2. Mosrespektimi i afateve të caktuara në përmbushjen e detyrave, të cilat kanë sjellë pasoja të rënda"* ndërlidhur me 8 paragrafi 1 dhe nenit 10 paragrafi 2 të Ligjit Nr.04/L-157 për Avokaturën Shtetërore ku përcaktohet se: *"1. Avokatura shtetërore përfaqëson, jep këshilla dhe mbron autoritetet publike të Republikës së Kosovës, të përcaktuara me Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë, në procedurën gjyqësore, të arbitrazhit dhe në procedurën administrative në pajtim me ligjin. 2. Avokatët shtetëror e informojnë Avokatin e Përgjithshëm Shtetëror për gjendjen e përfaqësimit të lëndëve"*, dhe ka ardhur në përfundimin se Komisioni Disiplinor me rastin e shqiptimit të masës disiplinore përmes Vendimit me numër KD.Nr.8/22 të datës 24.11.2022 ka konstatuar drejtë gjendjen faktike, ngase ankuesja në cilësi të Avokatit Shtetërore e cila ka qenë e ngarkuar me përfaqësimin e lëndës në fjalë pranë Gjykatës Themelore, pas pranimit të ftesës me datë 28.06.2022 për mbajtjen e seancës së shqyrtimit kryesor e cila ishte shtyrë paraprakisht, e deri në mbajtjen e seancës së shqyrtimit kryesor të datës 15.07.2022, rezulton se ankuesja nuk e ka ndërmarr asnjë veprim procedural më qëllim të përmbushjes së detyrave funksionale duke mos e njoftuar udhëheqësen e saj të drejtpërdrejtë për gjendjen e lëndës, gjegjësisht duke mos e njoftuar se Ministria e Shëndetësisë nuk ka arritur të sigurojë provat apo dosjen e lëndës për të cilën e njëjta ka kërkuar që ta përfaqësoj Avokatura Shtetërore, si dhe nuk ka bërë përpjeke që gjatë kësaj periudhe kohore gjegjësisht ndërmjet datave 28 qershor 2021 deri me 15 korrik 2021 të tentojë përsëri që Ministria e Shëndetësisë të sigurojë dosjen e lëndës, me theks të veçantë që ta vejë në dijeni se mos sigurimi i provave të lëndës mund të rezultojë me humbje të rastit dhe mbajtjen e barrës së përgjegjësisë materiale të kompensimit të palës paditëse.

Tutja, ankuesja mospjesëmarrjen në seancën e shqyrtimit kryesor të datës 15.07.2021 në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative e mbështet duke u thirr në neni 35.8 dhe 41 të Ligjit për Konfliktet Administrative si dhe në praktikën e Avokaturës shtetërore për mos marrjen pjesë në seancat gjyqësore në çështje administrative, mirëpo nenet e referuara si më lartë nuk kanë ndërlidhje me përmbushjen e detyrave funksionale të ankueses, ndërsa të njëjtat rregullojnë çështje procedurale në konfliktet e hapura administrative pranë gjykatës kompetente,

sikurse e njëjta nuk ka mundur ta dëshmojë me prova relevante të konfirmuara se avokatët shtetërorë janë të liruar të mos marrin pjesë në seanca gjyqësore në çështjet apo konfliktet e hapura administrative, prandaj një pretendim i tillë ankimor nuk është për ligjur pasi në rastin konkret nuk mund të ketë efekt përjashtues ndaj nenit 10 paragrafi 2 të Ligjit Nr.04/L-157 për Avokaturën Shtetërore sikurse në rastin konkret, ndërlidhur me obligimin që ankuesja ka pasur ndaj udhëheqësit të drejtpërdrejtë për lëndët në proces përfaqësimi.

Nga se u tha si më lartë, pas analizimit të shkresave të lëndës të ofruara nga palët në procedurë si dhe konstatimeve të dhëna si në arsyetimin e këtij vendimi, Kolegji i Këshillit ka konstatuar se pretendimet ankimore të ankueses janë pabazuar ndërsa ankesa e saj është refuzuar sikurse në dispozitivin e këtij vendimi, ndërsa akti i kontestuar përmes kësaj ankese, gjegjësisht Vendimi me numër KD.Nr.8/22 të Komisionit Disiplinor i Ministrisë së Drejtësisë i datës 24.11.2022 akt administrativ i ligjshëm sikurse i përmbush elementet e detyrueshme të aktit administrativ të përcaktuar me nenin 47 dhe 48 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, ndërsa Komisioni Disiplinor me rastin e nxjerrjes së këtij vendimi ka vepruar në pajtueshmëri me kompetencat e përcaktuara me nenin 48 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, ndërsa ka konstatuar saktë gjendjen faktike dhe bazën juridike pasi shkelja e ankueses i përmbush elementet e përgjegjësisë disiplinore të përcaktuara si në nenin 45 paragrafi 1 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publik, për shkak të mosveprimit të ankueses sipas detyrës zyrtare në rastin konkret.

Andaj, bazuar në këto rrethana, pas analizimit dhe vlerësimit të gjitha shkresave të lëndës si dhe duke u bazuar në kompetencën e Këshillit, gjegjësisht nenin 6 paragrafi 1 nën paragrafi 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nën paragrafin 1.1 të Ligjit Nr. 06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbiqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës si dhe nenin 132 paragrafi 2 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji i Këshillit vendosi si në dispozitiv të këtij Vendimi.

Këshillë juridike: Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur e cila pretendon se vendimi i Këshillit nuk është i ligjshëm mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë-Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.1205/2022

Avdyll Bekteshi

Zyrtar i Lartë për bashkëpunim Profesional

Malsore Gashi-BAJRAKTARI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet:

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm në Ministrinë e Drejtësisë;
- Udhëheqësit të Njësive së Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Drejtësisë dhe
- Arkivit të KPMSHCK-së.